



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdrastva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 03.07.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkeses për ri-shqyrtim të datës 03.07.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Argo Med" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Methadone nga LE" me nr. prokurimi 206-24-4993-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. Refuzohet, si e jashtafatshme kërkesa për rishqyrtim e OE "Argo Med" SH.P.K. e datës 03.07.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Methadone nga LE" me nr. prokurimi 206-24-4993-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontrate, të datës 21.05.2024 të publikuar në platformën elektronike;
- II. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor.
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me anulimin e aktivitetit të prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatorët Ekonomik "Argo Med" SH.P.K. dy dite para hapjes – sot me datë 03.07.2024 kanë parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Methadone nga LE" me nr. prokurimi 206-24-4993-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 03.07.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimet Ankimore të OE ankues:

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, para 3. i cili thekson:

“3. *Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:*

4.2 *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.*

Operatori Ekonomik ankues ka dorëzuar Kerkese per rishqyrtim me date 03.07.2024, ndersa hapja e ofertave eshte parapare me daten 05.07.2024.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.2. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që ka parashtruar ankesë pas afatit të fundit të lejuar 5 dite para dorëzimit të ofertave.

Nenin 60.1(a) i Rregullave të prokurimit publik

a) *Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.*

Nenin 63.2 i Rregullave të prokurimit publik

Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtror një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).

AK hedh poshte ankesen e parashtrua ne perputhje me nenin 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 cili nen percakton se:

Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit